



Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 49

Prishtinë, 8.6.2016 në ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Zhivković – kryetare, Mufera Sinik – nënkryetarja e dytë dhe anëtarët Sasha Milosavljević, Sllavko Simić, Millka Vuletić, Agim Kukaj, Qerim Bajrami, Veton Berisha e Danush Ademi.

Munguan: Agim Qeku – nënkryetari i parë dhe anëtarët Rrustem Berisha e Fisnik Ismajli.

Pjesëmarrësit tjerë: monitoruesi i OSBE-së dhe i Këshillit konstituiv të komuniteteve

Nga stafi mbështetës: Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi, Jasmina Zhivković, kryetare e Komisionit.

Në mbledhje është propozuar:

Rendi i ditës

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projekt ligjit nr. 05/L-10 për Agjencinë Kosovare për krahasim dhe verifikim të pronës me amendamente të Komisionit funksional për legjislacion, mandate, imunitet, Rregullore të Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër korrupsionit**

I ftuar: z. Jeton Oruçi – koordinatori i Zyrës ligjore pranë Zyrës të Kryeministrit;

- 3. Të ndryshme.**

Kryetarja konstatoi që është miratuar rendi i ditës dhe vazhdoi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës.

2. Shqyrtimi i Projekt ligjit nr. 05/L-10 për Agjencinë Kosovare për krahasim dhe verifikim të pronës me amendamente të Komisionit funksional për legjislacion, mandate, imunitet, Rregullore të Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër korrupsionit

Kryetarja Zhivković shkurtimisht ka përshkruar fazat e procesit të punës në Projekt ligjin e sipërpërmendur, sponsoruesi i të cilit është Zyra e Kryeministrit dhe që ka dalë si rezultatit i dialogut ndërmjet Beogradit e Prishtinës, me të cilin rregullohen pronat private, komerciale dhe të kishës. Ajo ka theksuar disa shqetësime të rëndësishme për aspektin përmbajtësor dhe thelbësor të çështjeve të caktuara: kjo rregullore nuk reflekton atë që është arrirë me dialogun nga Brukseli dhe vë dyshimin në mandatin e Agjencisë për verifikimin e pasurisë, e cila prezanton vetëm vazhdimin e Agjencisë së mëhershme, e cila deri tani është treguar si e pasuksesshme dhe jofunksionale ne punën e saj operative.

Ajo tha se puna në hartimin e Projekt ligjit ka filluar ne prillin e vitit 2011 dhe në punën e Grupit punues nuk ka qenë i përfshirë as pjesëtari i komunitetit serb e as të komuniteteve të tjera pakicë, gjë që prezanton shkelje të procedurës dhe vërejtjen - sepse e drejta e jonë është të mbrojmë interesat e komuniteteve dhe askush nuk ka të drejtë të na mohojë një të drejtë të tillë. Ajo shtoi se punën e Komisionit e përcjellë edhe një problem tjetër procedural, dhe ky është - Komisioni kritikohet se nuk respekton afatet për shqyrtimin e këtij Projekt ligji, domethënë shkel afatet për dërgimin e raportit për miratim në Kuvend, gjë që është e papranueshme si e tillë, sepse në anën tjetër i toleron Komisionit për legjislaturë mosrespektimin e afateve në procesin e shqyrtimit të projekt ligjeve, të cilat janë të përcaktuara me Rregulloren e punës së Kuvendit.

Komisioni konsideron se kompetencat e Komisionit funksional në kuptim të obligimeve koordinuese dhe të bashkëpunimit ndërmjet komisioneve parlamentare – nuk janë respektuar.

Ajo tha se, për shkak të kësaj gjendjeje, kanë qenë të nevojshme shpjegime të caktuara dhe bashkëpunimi me Zyrën ligjore pranë Zyrës së Kryeministrit, që të rregullohen problemet të cilat na dezorientojnë në këtë proces.

Ajo tha: “Konsideroj që Komisioni për të drejtat, interesat e komuniteteve dhe për kthim nuk e ka përcjellë për shqyrtim të dytë në seancën plenare, Raportin me rekomandime të këtij Projekt ligji, sepse i njëjti prek interesat vitale dhe të drejtat e komuniteteve, dhe një veprim i tillë nuk prezanton shkelje të rregullave të procedurës në procedimin e të njëjtit nga ana e Komisionit”.

Sasha Millosavljević i është bashkangjitur debatit dhe ka përkrahur qëndrimin e kryetares së Komisionit, duke theksuar se ky Projekt ligj është shumë i rëndësishëm për të drejtat e komuniteteve dhe interesat vitale të tyre dhe si të tillë nuk mund ta pranojnë, sepse përmban një

sërë mangësish në çështjen e pasurisë, jo vetëm të komunitetit serb, por edhe të të gjitha komunitetëve në tërësi.

Jeton Oruçi – koordinatori i Zyrës ligjore pranë Zyrës të Kryeministrit, ka shprehur falënderimin dhe kënaqësinë që i është dhënë mundësia të prezantojë para Komisionit shpjegime dhe informacione për problematiken e Ligjit të sipërpërmendur. Ai tha se ky ligj ka të bëjë me zgjidhjen e kërkesave në lidhje me pasurinë e paluajtshme në pronësi private, duke përfshirë pasurinë bujqësore, pasurinë e paluajtshme private duke përfshirë pronën komerciale si pasuri private të komunitetit fetar, dhe me krahasimin dhe zgjidhjen e dallimeve ndërmjet dokumenteve origjinale kadastrale të marra nga ana e autoriteteve serbe para qershorit të vitit 1999 dhe dokumentacionit aktual kadastral në Republikën e Kosovës.

Ai në vazhdim tha se strukturën e Agjencisë e përbëjnë: Bordi mbikëqyrës i Agjencisë, Sekretariati ekzekutiv, Komisioni për kërkesa pronësore dhe Komisioni për verifikimin dhe vendimmarrje për pronën; Bordi mbikëqyrës i Agjencisë mbikëqyrë punën administrative të Agjencisë dhe jep udhëzime për politikën dhe orientimet e përgjithshme të Agjencisë; Bordi përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve, dy prej të cilëve, me propozim të Kryeministrit, emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, kurse tre të tjerë, duke përfshirë edhe kryesuesin, i emëron përfaqësuesi special i Bashkimit Evropian, pas konsultimeve me Kryeministrin.

Ai tha: “Unë si koordinator i Zyrës ligjore deklaroj se me rastin e hartimit të tekstit punues të Projekt ligjit kanë qenë të ftuara palët e interesuara, me qëllim të respektimit të interesave të tyre, dhe grupet e tjera të interesit me të cilët ka të bëjë ky Ligj, dhe janë respektuar rregullat dhe procedurat në nxjerrjen e tij”.

Komisioni pas marrjes së shpjegimeve dhe informatave në hartimin e kësaj rregullative ligjore dhe votimit me 7 vota kundër dhe 2 vota për, ka nxjerrë këtë:

Përfundim

Projekt ligjin nr. 05/L-10 për Agjencinë Kosovare për krahasim dhe verifikim të pronës nuk mbështetet as në parim dhe as një nga një, në procesimin e mëtejshëm dhe miratim të tij.

3. Të ndryshme

Qerim Bajrami dhe Mufera Sinic në emër të Grupit parlamentar 6+ kanë informuar Komisionin për vërejtjet në Udhëzimin administrativ nr. 09/2016 “Aplikimi i masave afirmative dhe vendeve të rezervuara për regjistrim të kandidatëve nga komunitetet joshumicë në institucionet publike të arsimit të lartë”, të datës 03.06.2016, dhe i nënshkruar nga ministri i MASHT-it.

Ai tha: “Udhëzimi administrativ është i papranueshëm për ne, sepse ajo për të cilën jemi dakorduar në mbledhjen e fundit në mes të Ministrit dhe deputetëve të komunitetit joshumicë, nuk është respektuar, dhe me këtë rast shkelen të drejtat e komuniteteve joshumicë, në dy nene kontestuese, në regjistrimin e studentëve të tyre në vendet e rezervuara në fakultetet e universiteteve publike, për studim në gjuhën shqipe. Prandaj, ne kërkojmë që menjëherë të intervenohet në këto nene (4.1.5), dhe të korrigjohen gabimet”.

Mbledhja ka përfunduar në 12:20.

Përgaditur:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Jasmina Zhivkoviq